



HASHIM THAÇI DHE TË AKUZUARIT E TJERË SHPALLEN FAJTORË PËR KRIME LUFTE

Trupi Gjykses sot shqiptoi aktgjykimin në çështjen gjyqësore të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Trupi Gjykses konstatoi se të katër të akuzuarit ishin penalisht përgjegjës për krimet e luftës të ndalimit arbitrar kundër 385 personave, trajtimit mizor kundër 49 personave, torturës kundër 303 personave dhe vrasjes së paligjshme kundër 96 personave.

Trupi Gjykses i shpalli të akuzuarit të pafajshëm për krime kundër njerëzimit pasi Prokurori i Specializuar nuk arriti të vërtetonte jashtë dyshimit të arsyeshëm se ishte kryer sulm i përhapur gjerësisht ose sistematik kundër një popullate civile. Gjithashtu të akuzuarit u shpallën të pafajshëm në lidhje me një numër incidentesh krime lufte.

Trupi Gjykses dënoi Hashim Thaçin me 25 vjet burgim, Kadri Veselin me 18 vjet burgim, Rexhep Selimin me 13 vjet burgim dhe Jakup Krasniqin me 25 vjet burgim, duke llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim.

Gjykatësit konstatuan se gjatë konfliktit në Kosovë, z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi dhe z. Krasniqi dhanë kontribut të qenësishëm në zbatimin e qëllimit kriminal të përbashkët të shënjestrimit të atyre që konsideroheshin si kundërshtarë të qëllimeve politike dhe ushtarake të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përfshirë shqiptarë të Kosovës që kishin lidhje me forca politike ose ushtarake të tjera, si LDK-ja dhe FARK-u; persona që pretendohesh se kishin lidhje me autoritetet e RFJ-së/Serbisë, dhe anëtarë të caktuar të pakicave të tjera etnike, ndër të cilët një numër romësh dhe serbësh.

Shënjestrimi i këtyre kundërshtarëve mori formën e vrasjeve; arrestimeve dhe ndalimeve pa proces ligjor të rregullt; keqtrajtimit fizik dhe psikologjik; si dhe forma të tjera të keqtrajtimit, frikësimit dhe ngacmimit. Me përjashtime të kufizuara, Trupi Gjykses konstatoi se nuk kishte prova se ndonjë prej viktimave kishte qenë përfshirë në veprimtari kriminale, kishte marrë pjesë aktive në luftime, apo përbënte ndonjë shqetësim legjitim tjetër të sigurisë për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Shumica e gjerë e tyre ishin civilë të pafajshëm të cilët u bënë viktimë të zbatimit të planit kriminal të përbashkët, në të cilin u cilësuan - shpesh në mënyrë të rreme dhe përgjithësisht pa ndonjë bazë - si kolaboracionistë ose spiunë. Shumë viktimë treguan për pasojat afatgjata psikologjike dhe fizike të vuajtjeve të tyre.





Gjatë përcaktimit të dënimit, Trupi Gjykues vlerësoi me hollësi faktet përkatëse, peshën e krimeve, llojin dhe shkallën e përfshirjes personale të secilit prej të akuzuarve, si edhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Trupi Gjykues gjithashtu mbajti parasysh se disa viktimat ishin veçanërisht të cenueshme, për shembull për shkak të moshës së tyre apo për arsye se u detyruan të shihnin keqtrajtimin ose vrasjen e anëtarëve të familjeve të tyre.

Gjatë seancës, Kryegjykatësi theksoi se gjykimi nuk kishte të bënte me legjitimitetin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe synimin e saj për një Kosovë të pavarur, por me përdorimin e mjeteve të caktuara kriminale nga disa anëtarë të saj për realizimin e këtyre qëllimeve. Kryegjykatësi gjithashtu shpjegoi se gjykimi nuk kishte të bënte me krimet që, padyshim, forcat dhe paraushtarakët serbë kryen kundër shqiptarëve të Kosovës. Gjykimi kishte të bënte vetëm me pyetjet nëse ishin kryer krimet e pretenduara në Aktakuzë dhe nëse të akuzuarit mund të mbaheshin penalisht përgjegjës për to.

Roli i secilit prej të akuzuarve

Në lidhje me Hashim Thaçin, Trupi Gjykues konstatoi se, si anëtar i Shtabit të Përgjithshëm dhe si shef i Drejtorisë Politike, ai ishte anëtar kyç në formulimin dhe zbatimin e qëllimit të përbashkët që përfshinte ngritjen e objekteve të ndalimit; identifikimin e personave që konsideroheshin si kundërshtarë të UÇK-së; arrestimin dhe ndalimin e tyre; dhe, nëse ishte e nevojshme, vrasjen e tyre.

Këtu përfshihej shënjestrimi i “kolaboracionistëve” të pretenduar, krijimi i strukturës, organeve kompetente dhe rregulloreve për këtë qëllim, dhe përdorimi i “luftës speciale” kundër kundërshtarëve, përfshirë përmes publikimit të komunikatave dhe deklaratave politike e deklaratave të tjera publike ku shprehej tolerancë dhe inkurajim për kryerjen e krimeve kundër kundërshtarëve.

Trupi Gjykues më tej konstatoi se Hashim Thaçi gjithashtu mori pjesë personalisht në krime, përfshirë në arrestimin, ndalimin arbitrar dhe marrjen në pyetje të 13 parlamentarëve, dhe në arrestimin, ndalimin, transferimin dhe vrasjen e paligjshme të Behajdin Allaqit. Ai gjithashtu përhapi informacion të rremë për të ndaluarit dhe viktimat e krimeve të kryera nga anëtarë të UÇK-së, dha garanci të rreme për respektimin e të drejtës humanitare ndërkombëtare në emër të UÇK-së, si dhe kontribuoi në politikën e mosndëshkimit në lidhje me kryesit e krimeve kundër kundërshtarëve.





Në lidhje me Kadri Veselin, Trupi Gjykses konstatoi se, si shef i Drejtorisë së Zbulimit, ndër përgjegjësitë kryesore kishte identifikimin, sigurimin e informacionit, vëzhgimin dhe neutralizimin e personave që dyshohej se ishin “kolaboracionistë”.

Trupi Gjykses gjithashtu konstatoi se z. Veseli u përfshi personalisht në procesin e identifikimit dhe shënjestrimin të kundërshtarëve, shumë prej të cilëve në fund u vranë. Trupi Gjykses theksoi në këtë kontekst se i ashtuquajturit informacion zbulimi mbi bazën e të cilit shumë prej viktimave u arrestuan, u ndaluan dhe u vranë, nuk ishte më shumë se thjesht thashetheme të paverifikuara.

Trupi Gjykses arriti në konstatimin se pozita zyrtare e Rexhep Selimit si inspektor i përgjithshëm i dha atij më pak pushtet mbi anëtarët e tjerë të UÇK-së në dallim nga të akuzuarit e tjerë. Paneli megjithatë konstatoi se, si anëtar i Shtabit të Përgjithshëm dhe si shef i Drejtorisë Operative dhe inspektor i përgjithshëm i UÇK-së, ai nuk siguroi që UÇK-ja të vepronte në përputhje me detyrimet e saj sipas të drejtës humanitare ndërkombëtare, dhe, përkundrazi, toleroi shkelje të rënda të kësaj të drejte. Paneli gjithashtu konstatoi se z. Selimi mori pjesë në arrestimin dhe ndalimin e 13 parlamentarëve dhe kontribuoi në zbatimin e ndërmarrjes kriminale të përbashkët në mënyra të tjera të ndryshme.

Në lidhje me rolin e Jakup Krasniqit, Trupi Gjykses konstatoi se, si anëtar i Shtabit të Përgjithshëm dhe i Drejtorisë Politike, dhe si zëdhënës dhe zëvendëskomandant i UÇK-së, ai ishte anëtar kyç në formulimin dhe zbatimin e politikës së shënjestrimin të kundërshtarëve. Në veçanti, përmes publikimit të komunikatave dhe deklaratave politike e fjalimeve publike të tjera, si edhe urdhrave, z. Krasniqi inkurajoi kryerjen e krimeve kundër personave që konsideroheshin si kundërshtarë, përfshirë përmes “luftës speciale” të UÇK-së. Në këto deklarata, ndër të tjera, u mor përsipër përgjegjësia për vrasjen e, dhe “masat ndëshkuese” kundër, “kolaboracionistëve” dhe u shpreh inkurajim dhe tolerancë për krimet, si, për shembull, “kolaboracionistët paralajmërohen se do t’i vrasim nëse vazhdojnë në rrugën e gabuar”.

Atmosfera e frikësimit të dëshmitarëve

Trupi Gjykses nënvizoi se gjykimi u zhvillua në një atmosferë të vazhdueshme të frikësimit të dëshmitarëve. Disa dëshmitarë të thirrur nga Prokuroria në mënyrë oportuniste tërhoqën deklaratat e dhëna në të kaluarën, shmangën dhënien e detajeve themelore nga dëshmitë e mëparshme, gënjyën Trupin Gjykses, recituan fjali të mësuara paraprakisht ose ndryshuan dëshmitë që kishin dhënë më parë.





Megjithatë, Trupi Gjykses pranoi se shumica e dëshmitarëve që u paraqitën para Trupit Gjykses e bënë këtë me shumë guxim dhe vendosmëri; disa dëshmitarë e bënë këtë përkundër frikësimit dhe përpjekjeve për t'i shkurajuar që të dëshmonin.

Historiku i çështjes gjyqësore

Aktakuza fillestare kundër katër të akuzuarve u konfirmua më 26 tetor 2020, dhe u ndryshua më 3 shtator 2021, 29 prill 2022, dhe 30 shtator 2022. Versioni me më pak redakte i Aktakuzës u dorëzua më 27 shkurt 2023.

Pas arrestimit të tyre prej Prokurorit të Specializuar, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi u transferuan në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë, më 4 dhe 5 nëntor 2020.

Gjykimi filloi më 3 prill 2023 me deklaratën hyrëse të Prokurorisë. Prokuroria mbylli paraqitjen e provave të saj më 15 prill 2025. Mbrojtja e Viktimave që përfaqëson 156 viktimat pjesëmarrëse paraqiti provat e veta në korrik 2025, kurse Mbrojtja e Thaçit dhe Mbrojtja e Krasniqit paraqitën provat e tyre midis shtatorit dhe dhjetorit 2025. Trupi Gjykses mbylli procedurën e paraqitjes së provave më 19 dhjetor 2025 dhe deklaratat përmbyllëse u paraqitën prej 9 deri më 18 shkurt 2026.

Gjatë gjykimit, Trupi Gjykses mori provat e 273 dëshmitarëve, si në gjykatë ashtu dhe me shkrim. Trupi Gjykses pranoi 5467 prova materiale. Trupi Gjykses bëri konstatim gjyqësor për 1017 fakte të shqyrtuara në procese të tjera dhe për 29 fakte të pranuar. Gjithashtu, numri i faqeve të transkriptit në këtë proces gjyqësor arriti në 29238 faqe.

[Përmbledhjen](#) më të hollësishme të Aktgjykimit mund ta gjeni në faqen e internetit të DHSK-së.

